



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

**Forcimi i kuadrit rregullator për kontrollat zyrtare dhe kategorizimin e subjekteve në Shqipëri në kuadër të procesit të negociatave
E martë, 28 prill 2026, ora 10:00 – 12:30**

REKOMANDIME

Në kuadër të tryezës së diskutimit dhe këshillimit për Kapitullin 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të organizuar nga **Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)** në bashkëpunim me **Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, si dhe **Qendrën ALERT** si partner i projektit *“Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”*, financuar nga BE, në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin European dhe Konventën Kombëtare për Integrimin European, u trajtuan projektligji për kontrollat zyrtare, kategorizimi i subjekteve sipas standardeve të BE-së, edhe ligji për shëndetin e kafshëve i harmonizuar sipas Rregullores (BE) 2016/429. Më poshtë paraqiten rekomandimet e nxjerra nga diskutimet e mbajtura me pjesëmarrësit e tryezës që përfshinin përfaqësues të shoqërisë civile, të adakemisë, administratës publike, dhomave të biznesit, pushtetit vendor, etj.:

- Për subjektet që nuk i përmbushin ende standardet e BE-së, sidomos ato që i përkasin kategorisë së katërt sipas metodologjisë së vlerësimit, të parashikohet një periudhë afati e zgjeruar deri në vitin 2030 (afati final i përfundimit të negociatave), pa penalizime të menjëhershme si ndërprerja e veprimtarisë në treg, pasi ky proces nuk synon dënime, por standardizim dhe kategorizim gradual, dhe kështu shmangjen mbylljet e disa subjekteve.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me aktorët joshtetërorë si OSHC-të, duhet të ndihmojnë drejtpërdrejt subjektet në hartimin e këtyre planeve pune, duke specifikuar saktësisht kohën e nevojshme (p.sh. 1-2 vjet për çdo kategori), buxhetin konkret dhe fondet e kërkuara. Kjo qasje do të lejojë BE-në të asistojë me fonde të targetuara (p.sh. përmes IPA, EU4FoodSafety ose projekteve të

**Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 12 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin European”.*

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Bankës Botërore), ndërsa qeveria shqiptare të rrisë kontributin buxhetor për të kthyer kategorizimin në mundësi zhvillimi ekonomik e duke rritur besimin në produktet shqiptare.

- Për sa më sipër, vlen të përmendet që për kategori specifike p.sh. për subjektet që vlerësohen se i përkasin kategorisë 3, të lançohen fushata të dedikuara duke i ndihmuar të hartojnë plane pune të personalizuara për kalim në kategori më të larta (1 ose 2), bazuar plotësisht në udhëzimet e dhëna nga Ministria.
- Duke qenë se Ministria e Bujqësisë ka burime njerëzore të kufizuara, rekomandohet hartimi i një plani bashkëpunimi 4-vjeçar me aktorë të tjerë (OShC, universitete, ekspertë të pavarur), për të asistuar në plotësimin e detyrimeve negociuese. Kjo përfshin zbatimin e ligjeve të reja, si ai për kontrollet zyrtare nga 2027, duke siguruar kapacitete për auditime e raportime.
- Të krijohet një mekanizëm bashkëpunimi i ngushtë me sektorin e shoqërisë civile, akademisë dhe medias, për raportim të saktë dhe të paanshëm, duke shmangur keqinformimin që dëmton besimin publik. Kjo mund të realizohet përmes trajnimesh të përbashkëta, konferencash periodike dhe qasjeje të drejtpërdrejtë në të dhëna zyrtare, për të promovuar narrativën pozitive të progresit në Kapitullin 12 dhe produkteve vendase.
- Të intensifikohen fushatat ndërgjegjësuese për fermat dhe operatorët bujqësorë, duke i inkurajuar të aplikojnë në skema kombëtare të financimit. Këto fushata do të fokusohen në përmirësimin e biosigurisë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, duke e lidhur drejtpërdrejt me shtyllat kryesore të kapitullit.

**Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 12 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimit dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit "Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale", financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*